

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010) dhe neneve 10 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur me datën 09 nëntor 2012, miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR HAPJEN E ZYRAVE PËRFAQËSUSE BRENDA DHE JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e aprovimit për hapjen e një zyre përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, të cilat për të hapur një zyrë përfaqësuese jashtë Republikës së Kosovës, duhet të paraqesin kërkesë në formë të shkruar në BQK. Po ashtu kjo Rregullore aplikohet edhe për bankat e huaja, të cilat duhet të marrin leje të lëshuar nga BQK-ja për të hapur një zyrë të përfaqësimit në Republikën e Kosovës

Neni 2 Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikro-financiare dhe institucione financiare jo bankare (në vijim: Ligji për bankat) dhe/ose siç përcaktohen në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - a) *Bankë* -do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur, të licencuar nga BQK-ja;
 - b) *Bankë e huaj*- do të thotë personi që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licencë për t'u angazhuar në veprimtari bankare në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës;
 - c) *Zyrë përfaqësuese* - vend të aktivitetit afarist i cili formon një degë ligjërishit të varur të bankës e pa themeluar në vete, ku aktivitetet kufizohen në ofrimin e informatave dhe aktiviteteve të ndërlidhjes, si dhe studimit të tregjeve dhe mundësive të investimit ku banka nuk lejohet të angazhohet në veprimtari bankare.

Neni 3

Kërkesat për hapjen e zyrës përfaqësuese brenda Republikës së Kosovës

1. Banka e huaj, që aplikon për hapjen e zyrës përfaqësuese në Republikën e Kosovës siç është e përcaktuar në nenin 10 të Ligjit për bankat duhet të marrë aprovimin nga BQK-ja.
2. BQK-ja do të japë aprovim për hapjen e një zyre përfaqësuese të bankës së huaj në Republikën e Kosovës, pasi të ketë analizuar dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimin e organit kompetent të bankës së huaj për hapjen e zyrës përfaqësuese;
 - b) deklaratën e bankës së huaj, me anë të së cilës kjo e fundit angazhohet se do të zbatojë të gjitha detyrimet e rrjedhura/krijuara në Republikën e Kosovës në lidhje me veprimtarinë e zyrës përfaqësuese;
 - c) qëllimin e hapjes së saj;
 - d) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës përfaqësuese, adresën dhe numrin e telefonit;
 - e) emrat e personave të propozuar si drejtorë të zyrës së përfaqësimit të shoqëruar me curriculum vitae të tyre (arsimimin, profesionin, eksperiencën etj.);
 - f) numrin e parashikuar të punonjësve të zyrës;
 - g) dokumentin e regjistrimit të zyrës përfaqësuese në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
 - h) ndonjë aprovim nëse kërkohet nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës për hapjen e zyrës përfaqësuese.
3. Zyra përfaqësuese e një banke të huaj duhet të regjistrohet dhe të përdorë të njëjtin emër me atë të bankës amë, duke shtuar fjalët “Zyrë përfaqësimi”.
4. Zyra përfaqësuese mund të kryejë funksione të përfaqësimit dhe/ose administrative, ndonjë aktivitet promocional apo kërkime në treg në funksion të aktivitetit që ushtron banka e huaj, apo që kjo e fundit parashikon të ushtrojë në të ardhmen në Republikën e Kosovës. Zyra e përfaqësimit nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie bankare dhe/ose financiare, apo veprimtari tjetër komerciale.
5. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit për zyre përfaqësimi, BQK-ja aprovon ose refuzon kërkesën.

Neni 4

Kërkesat për hapjen e zyrës përfaqësuese jashtë Republikës së Kosovës

1. Për të hapur një zyrë përfaqësimi jashtë Republikës së Kosovës, bankat e licencuara nga BQK-ja për të kryer aktivitet në Kosovë, duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim në BQK.

2. Dokumentacioni i mëposhtëm është i kërkuar për hapjen e zyrës përfaqësuese:

- a) vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Kosovës;
- b) vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë për zyrën përfaqësuese prej bankës aplikuese, sipas rastit nga zyra e përfaqësimit e propozuar;
- c) një kopje të rregulloreve dhe objektivave të zyrës së përfaqësimit të propozuar, ku do të përcaktohen aktivitetet që do të kryhen;
- d) shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;
- e) informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të zyrës së përfaqësimit, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;
- f) strukturën organizative të zyrës përfaqësuese së bashku me numrin e punonjësve të propozuar; dhe
- g) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës së përfaqësimit.

3. BQK-ja jep miratimin paraprak për zgjerimin e bankës jashtë Republikës së Kosovës pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar në pajtueshmëri me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike prej datës së pranimin të aplikacionit për zyrë përfaqësimi, BQK-ja aprovon ose refuzon kërkesën.

Neni 5 Dënimet penale

Kryerja e veprimtarive bankare pa posedim të licencës bankare dhe paraqitja e informatave të falsifikuara dhe të rrejshme lidhur me aplikacionin për licencë konsiderohet vepër penale sipas nenit 84 të Ligjit për bankat dhe janë subjekt i dënimeve penale.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës